



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

*H-020/04-104751/24*, më 09 AUG 2024

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet caktimi i organit mbikëqyrës për "Kontratën në shtëpi për ndërtimin e profileve mbajtëse dhe vendosjen e flamurëve" e lidhur ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe NPL "Gjelbër" Sh.A. me nr. 14-024/01-225647/23 e dt. 27.11.2023.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, anëtarë të organit mbikëqyrës janë:
  1. Ervehe Zogaj, menaxhere e kontratës, Drejtorja e Shërbimeve Publike;
  2. Liridona Kastrati, mbikëqyrëse e kontratës, Drejtorja e Shërbimeve Publike.
3. Detyrat dhe punët e organit mbikëqyrës të cekur në pikën 2 të këtij vendimi janë: Mbikëqyrja e kontratës dhe përpilimi i raporteve për gjendjen e konstatuar, masave dhe veprimeve që janë marrë sipas obligimeve të përcaktuara në kontratë.
4. Për kryerjen e punëve si në pikën 3 të këtij Vendimi, organi mbikëqyrës do t'i raportojë Kryetarit të Kryeqytetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij.

**I DORËZOHET:**

- Anëtarëve të organit mbikëqyrës;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
Përparim Rama

